 <b>SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA</b> Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia <small>IRCCS Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in oncologia</small>	<b>FORMULAR</b>	Fq. <b>1 e 4</b>
	<b>REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PASTRIMIN E INTESTINIT PËR KOLONSKOPI</b>	Kodi <b>MO 35</b>
DIPARTIMENTO ONCOLOGICO E TECNOLOGIE AVANZATE (Departamenti Onkologjik dhe Teknologji të Avancuara) GASTROENTEROLOGJIA - ENDOSKOPIA DIGJESTIVE		Rev .00 i datës <b>01/02/23</b>

### REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PASTRIMIN E INTESTINIT PËR KOLONSKOPI

Është e nevojshme të shmangni përdorimin e frutave me fara (për shembull kiwi, luleshtrydhe, rrush, shalqi) dhe të perimeve (për shembull domate dhe sallata në përgjithësi) në 3 ditët para ekzaminimit, sepse ato mund ta bëjnë ekzaminimin e vështirë, duke kufizuar gjithashtu saktësinë.

Gjatë kohës që merrni preparatin dhe deri në dy orë përpara takimit për ekzekutimin e ekzaminimit lejohet të pini ujë, çaj, kamomil, elb, eventualisht edhe me sheqer.

Një ditë para ekzaminimit dieta është e lirë, por e lehtë (për shembull një supë). Nuk është e mundur të futen në dietë ushqime pasi të ketë filluar përgatitja

Shfaqja e mundshme e të pështjellëtisë ose e neverisë gjatë marrjes së produktit është normale dhe nuk është shqetësuese. Mjafton ta merrni produktin më ngadalë në gllënjka të vogla (nëse ruhet në frigorifer mund të jetë më i këndshëm) dhe shija mund të korrigojë duke e shoqëruar me pije të tjera me shije të ndryshme (çaj, kamomil etj.).

Në rast të simptomave të rëndësishme këshillohet të kontaktoni mjekun tuaj kurues.

Është e rëndësishme që ta merrni krejtësisht preparatin me metodën e treguar në mënyrë që ekzaminimi të mund të kryhet në mënyrë adekuate; një përgatitje jo e plotë zvogëlon saktësinë e kolonskopisë dhe mund të bëhet e nevojshme përsëritja e procedurës.

Koha që duhet të kalojë ndërmjet përfundimit të marrjes së preparatit dhe ekzekutimit të kolonskopisë duhet të përfshihet ndërmjet 2 dhe 4 orë. Nëse përpara se të përfundojë përgatitja evakuimet e fundit nuk janë me lëng të qartë/verdhë ashtu siç dëshirohet, merrni parasysh mundësinë e marrjes së një preparati tjetër ose të paktën të pini lëngje të tjera të me ngjyrë të qartë

Më poshtë po rendisim përgatitjet e ndryshme të disponueshme


PREPARAT ME VOLUM TEPËR TË ULËT: **PLENVU** (me bazë PEG dhe acid askorbik)

PREPARATE ME VOLUM TË ULËT: **CLENSIA** (me bazë PEG dhe acid citrik), **MOVIPREP** (me bazë PEG dhe acid askorbik)

PREPARATE ME VOLUM TË LARTË: **SELG ESSE** (me bazë polietilenglikoli-PEG dhe fosfat sodiumi)

Paralajmërimet:

- Preparatet me volum të ulët dhe shumë të ulët nuk këshillohen te pacientët me kapsllëk (më pak se 3 jashtëqitje në javë)

 <b>SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA</b> Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia <small>IRCCS Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in oncologia</small>	<b>FORMULAR</b>	Fq. <b>2 e 4</b>
	<b>REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PASTRIMIN E INTESTINIT PËR KOLONSKOPI</b>	Kodi <b>MO 35</b>
<b>DIPARTIMENTO ONCOLOGICO E TECNOLOGIE AVANZATE (Departamenti Onkologjik dhe Teknologji të Avancuara) GASTROENTEROLOGJIA - ENDOSKOPIA DIGJESTIVE</b>		<b>Rev .00 i datës 01/02/23</b>

- në pacientët me patologji të rëndësishme kardiologjike ose nefrologjike, konsultohuni me specialistin e referimit (për të shmangur prishjen e ekuilibrit të elektrolitit).

Kundërindikime:

PLENVU e MOVIPREP janë të kundërindikuar në pacientët e prekur nga fenilketonuria (për shkak të pranisë së fenilalaninës) dhe në pacientët me mungesë të glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës = favizëm (për shkak të pranisë së acidit askorbik/askorbatit).

### PLENVU

Si duhet ta merrni përgatitjen:

Doza 1 (duhet të pihet në gjysmë ore e tretur në gjysmë litër ujë) dhe më pas pini gjysmë litër ujë

Pas një ore pini Dozën 2A + 2B (të tretur në gjysmë litër ujë) dhe më pas pini gjysmë litër ujë

Kur duhet të merret përgatitja (oraret e sugjeruara)

ORARI kolonskopia 8.00-14.00

Mbrëmja përpara ekzaminimit

Nga ora 19.00 në 20.00 pini dozën 1 me PLENVU brenda 30 minutave të tretur në gjysmë litër ujë dhe më pas pini gjysmë litër ujë

Mëngjesi i ekzaminimit

Nga ora 5.30 deri në orën 6.30 pini dozën 2 me PLENVU brenda 30 minutave (shkrini përmbajtjen e dozës 2A dhe të dozës 2B duke i ngjitur bashkë në një gjysmë litër ujë) dhe më pas pini 1 litër ujë


-----  
ORARI kolonskopia Pas orës 14.00

Mëngjesi i ekzaminimit

Në orën 7.00 pini dozën 1 me PLENVU brenda 30 minutave (shkrini përmbajtjen e dozës 1 në një gjysmë litër ujë) dhe më pas pini gjysmë litri ujë

Në orën 8.00 pini dozën 2 me PLENVU brenda 30 minutave (shkrini përmbajtjen e dozës 2A dhe të dozës 2B duke i vënë bashkë në një gjysmë litër ujë) dhe pastaj pini 1 litër ujë

VINI RE: MOS NDËRRONI rendin e dozave, më përpara Doza 1 pastaj Doza 2A+2B.

 <b>SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA</b> Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia <small>IRCCS Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in oncologia</small>	<b>FORMULAR</b>	Fq. <b>3 e 4</b>
	<b>REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PASTRIMIN E INTESTINIT PËR KOLONSKOPI</b>	Kodi <b>MO 35</b>
<b>DIPARTIMENTO ONCOLOGICO E TECNOLOGIE AVANZATE (Departamenti Onkologjik dhe Teknologji të Avancuara) GASTROENTEROLOGJIA - ENDOSKOPIA DIGJESTIVE</b>		<b>Rev .00 i datës 01/02/23</b>

### CLENSIA E MOVIPREP

Si duhet ta merrni përgatitjen

Clensia: konfeksioni përmban 4 bustina A (të mëdha) dhe 4 bustina të vogla B (të vogla). Dy bustinat A dhe 2 bustinat B duhet të përgatiten me 1 litër ujë i cili do të pihet brenda një ore.

Moviprep: konfeksioni përmban 2 zarfe transparent ku secili përmban një bustinë të madhe A dhe një bustinë të vogël B. Një litër moviprep përgatitet duke shkrirë së bashku në 1 litër ujë një bustinë A dhe një bustinë B derisa të treten plotësisht (tretësirë e kthjellët). Solucioni i përgatitur duhet të pihet brenda një ore.

Kur duhet të merret përgatitja (oraret e sugjeruara)

Orari i kolonskopisë 8.00-10.00

Mbrëmja përpara ekzaminimit: 1 litër me preparat nga ora 20.00 deri në 21.00 pastaj gjysmë litri ujë

Mëngjesi i ekzaminimit: 1 litër me preparat nga ora 5.30 deri në 6.30 pastaj gjysmë litri ujë

-----

Orari i kolonskopisë 10.00-14.00

Mbrëmja përpara ekzaminimit: 1 litër me preparat nga ora 20.00 deri në orën 21.00 pastaj gjysmë litri ujë

Mëngjesi i ekzaminimit: 1 litër me preparat nga ora 6 deri në 7 pastaj gjysmë litri ujë

-----

ORARI i kolonskopisë pas orës 14:00

Mëngjesi i ekzaminimit: 2 litra me preparat nga ora 8.00 deri në 10.00 pastaj një litër ujë

### SELG ESSE (me bazë polietilenglikoli-PEG dhe fosfat sodiumi)

Si duhet ta merrni përgatitjen: shkrini secilën nga 4 bustinat me SELG në 1 litër ujë jo me gaz (ose lëngje të qarta)

Kur duhet të merret përgatitja (oraret e sugjeruara)

Orari i kolonskopisë 08.00-10.00


Mbrëmja përpara ekzaminimit: 3 litra nga ora 19.00 deri në orën 22.00

Mëngjesi i ekzaminimit: 1 litër nga ora 5,30 deri në orën 6,30

-----

Orari i kolonskopisë 10.00-14.00

Mbrëmja përpara ekzaminimit: 2 litra nga ora 19.00 deri në orën 21.00

 <b>SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA</b> Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia <small>IRCCS Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in oncologia</small>	<b>FORMULAR</b>	Fq. <b>4 e 4</b>
	<b>REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PASTRIMIN E INTESTINIT PËR KOLONSKOPI</b>	Kodi <b>MO 35</b>
DIPARTIMENTO ONCOLOGICO E TECNOLOGIE AVANZATE (Departamenti Onkologjik dhe Teknologji të Avancuara) GASTROENTEROLOGJIA - ENDOSKOPIA DIGJESTIVE		Rev .00 i datës <b>01/02/23</b>

Mëngjesi i ekzaminimit: 2 litra nga ora 5,30 deri në orën 7,30

-----

Orari i kolonskopisë Pas orës 14.00

Mëngjesi i ekzaminimit: 4 litra nga ora 7.00 deri në orën 11.00